

KONFERENCA MBI VIZIONIMIN SI MJET I PLANIFIKIMIT PJESEMARRËS

CONFERENCE ENVISIONING AS A PARTICIPATORY PLANNING TOOL

KONFERENCA O VIZIJE KAO SREDSTVO U PARTICIPATIVNOG PLANIRANJA

09. 11. 2010 - 9:30h

* **Grand Hotel**

Prishtina / Prishtinë / Prisitna

Vizionimi si mjet i planifikimit pjesëmarrës

INFORMATË MBI KONFERENCËN

Punëtoritë pesë ditore të vizionimit, me një përfshirje të grupeve të ndryshme të interesit nga nëntë komunat e Kosovës, kanë qenë një ndër aktivitetet kryesore të Programit për Mbështetjen e Planifikimi Hapësinor Komunal (PMPHK) faza 1/2 dhe mënyra të veçanta në metodologjinë e planifikimit. Qëllimi kryesor i këtyre punëtorive ishte nxjerrja e ideve nga qytetarët për planifikimin hapësinor dhe urban afatgjatë dhe afatshkurtër si të dhëna për hartimin e Planeve Zhvillimore Komunale dhe Urbane dhe implementimin e tyre. PMPHK ka zhvilluar një ‘format’ të këtyre punëtorive që iu kanë ofruar pjesëmarrësve një trajnim bazik mbi parimet e planifikimit e që fokusohen në ‘të mësuarit duke vepruar’. Pa dyshim që punëtoritë e vizionimit kanë qenë aktivitetet më gjithëpërfshirëse të planifikimit që ndonjëherë janë bashkë-organizuar nga komunat e Kosovës e që kanë fuqizuar shoqërinë civile që të kontribuojnë në mënyrë proaktive në planifikimin komunal dhe urban.

Prandaj, për të kuptuarit më të mirë të fuqisë së vizionimit pjesëmarrës si mjet i planifikimit e poashtu të organizimit të ardhshëm territorial si dhe të menaxhimit të ndonjë lagjeje, qyteti ose regjioni bazuar në vizionin dhe konceptet e përbashkëta, është përpiluar projekti i ashtuquajtur “Teknika e Vizionimit në Planifikimin Pjesëmarrës” brenda PMPHK.

Projekti synon të rrisë qeverisjen e mirë përmes metodave të planifikimit pjesëmarrës dhe çështjeve të ndjeshme gjinore. Rezultatet e projektit kanë të bëjnë me vështrimet e sigurisë së komunitetit, planet hapësinore/urbane, udhëzimet mbi dizajnin urban dhe mënyrat për aplikimin praktik të metodologjisë së vizionimit.

Përderisa fokusi i ciklit të parë të vizionimit ishte tërësisht në nivelin komunal, faza tjetër do ta adresojë ose ‘shkallën më të lartë’ (ndër-komunal, regjional, ndër-kufitar, transnacional) ose ‘shkallën më të ulët’ (qendër urbane, fshat, vendbanim joformal, lagje, rrugë, një bllok ndërtimi,...).

Sidoqoftë, punëtoritë e vizionimit do të jenë të nevojshme si pjesë e procesit të planifikimit përfshirës gjatë përkrahjes së komunave më të vogla në hartimin e Planeve Zhvillimore Komunale dhe Urbane dhe në vendosjen e një kornize të planifikimit.

Si rezultat i gjithë kësaj, më 9 Tetor, 2009, është mbajtur tryeza e rrumbullakët me temën “ Teknika e Vizionimit në Planifikimin Pjesëmarrës”.

Zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile nga nëntë komunat partnere të PMPHK, u mblodhën në këtë tryezë për të diskutuar të arriturat e punëtorive të vizionimit si dhe ndikimin e tyre në komuna. Një prej konkluzioneve kryesore ishte që të gjitha eksperiencat dhe mësimet e mësuara duhet t’ju përcillen edhe komunave të tjera.

Konferenca mbi Vizionimin si mjet i planifikimit pjesëmarrës do t’i sjell së bashku një varg komunash duke filluar prej atyre që janë në fillim të procesit të planifikimit hapësinor deri tek ato që kanë arritur në fazën e implementimit të planeve të tyre hapësinore dhe urbane.

Konferenca nuk do të ofrojë vetëm një vështrim të asaj që është bërë në ciklin e parë të punëtorive të vizionimit por gjithashtu do të nxjerr rekomandime dhe udhëzime për ciklin e ardhshëm të vizionimit, të rezultuar në Notë Këshillëdhënëse nga PMPHK për bashkëpunëtorët e tij në nivelin qendror dhe lokal.

FTESË

Tetor, 2010

E/I Nderuar/a Zonjë/Zotëri,

Me kënaqësi jeni të ftuar të merrni pjesë në “Konferencën mbi Vizionimin si mjet i planifikimit pjesëmarrës”. Konferenca është organizuar nga UN-HABITAT/ Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal“ (PMPHK) i financuar nga Sida, dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përkrahur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Friedrich Ebert Stiftung dhe Trashëgimia Kulturore pa Kufij.

Punëtoritë e vizionimit kanë qenë aktivitete të planifikimit gjithëpërfshirës, të organizuara më një pjesëmarrje aktive të zyrtarëve të pushtetit lokal dhe organizatave të shoqërisë civile nga nëntë komunat e Kosovës.

Qëllimi kryesor i Konferencës është të kuptuarit e mirëfilltë të fuqisë së vizionimit pjesëmarrës si mjet i planifikimit dhe ndikimin e tij në organizimin e ardhshëm territorial dhe menaxhimin e ndonjë lagjeje, qyteti ose regjioni bazuar në konceptet dhe vizionin e përbashkët. Gjithashtu, synon ngritjen e qeverisjes së mirë përmes metodave të planifikimit pjesëmarrës dhe çështjeve të ndjeshme gjinore.

Konferenca do t'i sjellë së bashku një numër të komunave duke filluar prej atyre që janë në fillim të procesit të planifikimit hapësinor deri tek ato që janë duke i implementuar planet e tyre. Gjithashtu, konferenca do të ofrojë mundësinë e shkëmbimit të eksperiencave me përfaqësuesit e shteteve të ndryshme mbi temat e ndërlidhura.

Konferenca nuk do të ofrojë vetëm një vështrim të asaj që është bërë në ciklin e parë të punëtorive të vizionimit por gjithashtu do të nxjerr rekomandime dhe udhëzime për ciklin e ardhshëm të vizionimit, të rezultuar në Notë Këshillëdhënëse nga PMPHK për bashkëpunëtorët e tij në nivelin qendror dhe lokal.

Konferenca do të mbahet në Hotel Grand, Prishtinë/Priština, më 9 Nëntor, 2010, duke filluar në 09:30.

Sinqerisht,

Mahir Yagcilar
Ministër
Ministria e Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor

Krystyna Galezia
Kryesuese
UN-HABITAT
Programet në Kosovë

AGJENDA

09:30-10:00 Fjala hyrëse:

Z. **Mahir Yagcilar** – Ministër i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Znj. **Krystyna Galezia** – Kryekëshilltare Teknike/Menaxhere e Programit/UN-HABITAT/ Kosovë
Përfaqësues – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Z. **Anders Berlin** – Kryesues i Sida-s Kosovë
Znj. **Besa Luzha** – Kryesuese e fondacionit Friedrich Ebert – Zyra në Kosovë
Z. **Sali Shoshi** – Kryesues i Trashëgimisë Kulturore pa Kufij – Zyra në Kosovë

10.00-11.00 Sesioni i parë:

a. Prezantim: Përmbledhje e nëntë punëtorive të vizionimit në PMPHK1/2; rezultatet e suksesshme/vështirësitet/ dobite dhe ndikimet në planifikim
Arijeta Himaduna & Ishaku Maitumbi
b. Prezantim: Departamenti i Planifikimit Hapësinor (MMPH)
Situata aktuale nëpër komuna
c. Eksperienca nga Suedia mbi planifikimin pjesëmarrës me shembuj konkret – Z. **Steve Johnson** – Kryesues i Departamentit për Planifikimin e Qëndrueshëm të Komunitetit dhe për Zhvillim
Diskutim

11:00-11:30 Pauzë për kafe

11:30-12:45 Sesioni i dytë:

Eksperienca e komunave mbi procesin e planifikimit pjesëmarrës:
a. Prezantimi nga Komuna e Junikut– Znj. **Ferdone Tofaj** - Drejtorja e Urbanizmit
b. Prezantimi nga Komuna e Hanit të Elezit– z. **Nexhmedin Daci** – Drejtorja e Urbanizmit
c. Prezantimi nga Komuna e Mitrovicës – z. **Mehdi Bala** – Drejtorja e Urbanizmit
Diskutim

12:45-14:00 Dreka

14:00-15:10 Sesioni i tretë:Pauzë për kafe

Z. **Flamur Kuçi**
Eksperienca nga Shqipëria mbi planifikimin pjesëmarrës - (20')
Znj. **Nuran Zeren Güler soy**
Eksperienca nga Turqia mbi planifikim pjesëmarrës me shembuj konkret – Universitetit Teknik i Stambollit

15:10-15:25 Pauzë për kafe

15:25-16:25 Sesioni i katërt:

Z. **Luan Shllaku** – Drejtor ekzekutiv i KFOS-it - (10')
Idetë e ardhshme mbi vizionimin dhe planifikimin e komunitetit
Z. **Ilir Gjinolli** – Ligjërues në Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe Arkitekturës / Universiteti i Prishtinës - (10')
Znj. **Elvida Pallaska** – Instituti i Planifikimit Hapësinor - MMPH - (10')
Diskutim

16:25 –17:00 Rekomandimet – cikli i rdhshëm i punëtorive të vizionimit